

P R O J E K T L I G J

Nr. ____/2026

PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË ARTISTËVE PERFORMUES PAS NDËRPRERJES SË VEPRIMTARISË ARTISTIKE SKENIKE

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e
Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

V E N D O S I

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj përcakton kushtet, kriteret dhe procedurat për përfitimin e trajtimit financiar nga punonjësit që kanë ushtruar profesione artistike performuese në institucionet publike të artit dhe kulturës, pas përfundimit të veprimtarisë së tyre profesionale skenike dhe deri në lindjen e të drejtës për pension pleqërie, invaliditeti ose familjar, sipas legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqërore.

Neni 2

Përkufizime

1. Për qëllime të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Institucion publik i artit dhe kulturës” është personi juridik publik, i krijuar dhe i organizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, i cili ushtron veprimtari në fushën e artit dhe kulturës;
- b) “Profesioni artistik performues” është profesioni i ushtruar në mënyrë të drejtpërdrejtë në skenë, në kuadër të marrëdhënies së punës me një institucion publik të artit dhe kulturës, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- c) “Periudhë e performancës skenike” është periudha e dokumentuar gjatë së cilës individi ka ushtruar një profesion artistik performues në kuadër të marrëdhënies së punës me një institucion publik të artit dhe kulturës;

ç) “Subjekt përfitues” është individ i që ka ushtruar një profesion artistik performues në një institucion publik të artit dhe kulturës dhe që plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj për përfitimin e trajtimit financiar;

d) “Trajtim financiar” është përfitimi monetar periodik që i jepet subjektit përfitues pas përfundimit të marrëdhënies së punës, nga data e përfundimit të marrëdhënies së punës, në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 3

Subjektet përfituese

1. Subjekte përfituese, sipas këtij ligji, janë individët që kanë qenë në marrëdhënie pune pranë institucioneve publike të artit dhe kulturës dhe kanë ushtruar veprimtari artistike performuese në skenë, për një periudhë jo më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji.

2. Profesionet artistike performuese, për qëllime të përfitimit nga ky ligj, ndahen në këto kategori:

a) Profesionet e interpretimit fizik në skenë:

i. akrobat;

ii. balerin;

iii. valltar.

b) Profesionet e interpretimit vokal në skenë:

i. këngëtar-solist lirik;

ii. këngëtar-korist.

3. Lista e institucioneve publike të artit dhe kulturës që përfshihen në fushën e zbatimit të këtij ligji, si dhe dokumentacioni dhe procedurat e verifikimit të periudhave të performancës skenike, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Kushtet e përfitimit

1. Punonjësit e përcaktuar në nenin 3 të këtij ligji përfitojnë trajtim financiar pas përfundimit të marrëdhënies së punës, kur plotësojnë njëkohësisht kushtet e përcaktuara në këtë nen.

2. Për profesionet e interpretimit fizik në skenë, e drejta për përfitimin e trajtimit financiar lind kur subjekti përfitues:

a) ka mbushur moshën 47 vjeç;

- b) ka jo më pak se 15 vjet periudhë të performancës skenike;
- c) ka jo më pak se 15 vjet periudhë sigurimi shoqëror.
- 3. Për profesionin e këngëtarit lirik - solist, e drejta për përfitimin e trajtimit financiar lind kur subjekti përfitues:
 - a) ka mbushur moshën 57 vjeç;
 - b) ka jo më pak se 20 vjet periudhë të performancës skenike;
 - c) ka jo më pak se 20 vjet periudhë sigurimi shoqëror.
- 4. Për profesionin e këngëtarit lirik - korist, e drejta për përfitimin e trajtimit financiar lind kur subjekti përfitues:
 - a) ka mbushur moshën 57 vjeç;
 - b) ka jo më pak se 20 vjet periudhë të performancës skenike;
 - c) ka jo më pak se 25 vjet periudhë sigurimi shoqëror.
- 5. Përfitimi i trajtimit financiar sipas këtij ligji nuk cenon të drejtën për përfitimin e pensionit të pleqërisë, pensionit të invaliditetit ose pensionit familjar, sipas legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqërore.
- 6. Trajtimi financiar përfitohet nga data e përfundimit të marrëdhënies së punës, në kushtet e përcaktuara në këtë ligj, dhe vijon deri në lindjen e të drejtës për pension, sipas legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqërore.
- 7. Punonjësi që plotëson kushtet e përcaktuara në këtë nen kalon në skemën e trajtimit financiar, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji. Plotësimi i këtyre kushteve përbën shkak të posaçëm ligjor për përfundimin e marrëdhënies së punës, për efekt të kalimit në skemën e trajtimit financiar, dhe përfundimi i marrëdhënies së punës kryhet nga institucioni publik i artit dhe kulturës në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji, duke respektuar të drejtat dhe garancitë procedurale të punëmarrësit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 5

Masa e përfitimit

- 1. Masa e trajtimit financiar është 70 për qind e pagës bruto mujore të përfituar nga subjekti përfitues në muajin e fundit të marrëdhënies së punës.
- 2. Masa e trajtimit financiar të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni përfitohet për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh nga data e fillimit të përfitimit.
- 3. Pas përfundimit të periudhës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, masa e trajtimit financiar është 50 për qind e pagës neto mujore të referencës për profesionin dhe kategorinë përkatëse, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

4. Masa e trajtimit financiar përfitohet deri në datën e lindjes së të drejtës për pensionin e pleqërisë, pensionin e invaliditetit ose pensionin familjar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurimet shoqërore.

Neni 6

Lindja e të drejtës dhe procedura për përfitimin e trajtimit financiar

1. Kur punonjësi plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji, institucioni publik i artit dhe kulturës ka detyrimin të fillojë procedurën e kalimit të tij në skemën e trajtimit financiar. Përfundimi i marrëdhënies së punës dhe fillimi i përfitimit të trajtimit financiar kryhen sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Institucioni publik i artit dhe kulturës, pas verifikimit të përmbushjes së kushteve të përcaktuara në këtë ligj, njofton me shkrim subjektin përfitues për:

a) plotësimin e kushteve për përfitimin e trajtimit financiar;

b) procedurat që duhet të ndiqen për përfundimin e marrëdhënies së punës dhe përfitimin e trajtimit financiar;

c) afatet procedurale dhe dokumentacionin që duhet të paraqitet për përfitimin e trajtimit financiar.

3. E drejta për të përfituar trajtimin financiar, sipas këtij ligji, nuk parashkruhet.

4. Pas përfundimit të verifikimit dhe konstatimit të plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji, institucioni publik i artit dhe kulturës nxjerr aktin për përfundimin e marrëdhënies së punës dhe kalimin e subjektit në skemën e trajtimit financiar, sipas pikës 7 të nenit 4 të këtij ligji. Akti i njoftohet subjektit përfitues dhe përmban datën e përfundimit të marrëdhënies së punës, datën e fillimit të trajtimit financiar dhe informacionin mbi mjetet juridike të ankimit, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Në rast se subjektit përfitues, gjatë periudhës së përfitimit të trajtimit financiar, i lind e drejta për përfitimin e pensionit të pleqërisë, pensionit të invaliditetit ose pensionit familjar, përfitimi i trajtimit financiar ndërpritet nga data e fillimit të përfitimit të pensionit.

6. Institucioni përgjegjës për administrimin e përfitimit, në bashkëpunim me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, verifikon periodikisht nëse ka lindur e drejta e subjektit përfitues për pension pleqërie, pension invaliditeti ose pension familjar, si dhe nëse ekzistojnë shkaqe të tjera për ndërprerjen e përfitimit sipas këtij ligji.

7. Për qëllimet e pikës 6 të këtij neni, institucionet përkatëse kanë detyrimin të shkëmbejnë informacion çdo 6 (gjashtë) muaj.

Neni 7

Periodha e sigurimit dhe kontributet

1. Periodha gjatë së cilës subjekti përfitues merr trajtim financiar, sipas këtij ligji, njihet si periudhë sigurimi për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë, pensionit të invaliditetit dhe pensionit familjar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurimet shoqërore.
2. Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën e përfitimit të trajtimit financiar përballohen nga Buxheti i Shtetit dhe llogariten mbi bazën e pagës bruto të referencës për profesionin dhe kategorinë përkatëse, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Kontributet e sigurimeve shoqërore derdhen për çdo muaj gjatë periudhës së përfitimit të trajtimit financiar, deri në lindjen e së drejtës për pension, sipas legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqërore, dhe në përputhje me kufijtë e pagës mbi të cilën llogariten kontributet e detyrueshme.
4. Administrimi, llogaritja, deklarimi dhe pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore kryhen nga institucioni përgjegjës, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 8

Financimi

1. Trajtimi financiar i parashikuar në këtë ligj financohet nga Buxheti i Shtetit.
2. Buxheti i Shtetit përballon edhe shpenzimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të subjekteve përfituese, sipas nenit 7 të këtij ligji.
3. Mënyra e llogaritjes, administrimit, financimit dhe pagesës së trajtimit financiar, përcaktimi i institucionit përgjegjës për administrimin dhe kryerjen e pagesave, si dhe procedurat për administrimin, deklarimin dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Subjektet përfituese, me kërkesë të institucionit publik të artit dhe kulturës, angazhohen, pa shpërblim shtesë për 250 orë në vit kalendarik, në veprimtari trajnuese, promovuese, artistike, kulturore ose mentorim profesional, në përputhje me aftësitë dhe mundësitë e tyre.

5. Angazhimi i përcaktuar në pikën 4 të këtij neni nuk përbën marrëdhënie pune dhe nuk mund të përfshijë detyrimin për ushtrimin e rregullt të profesionit artistik performues për të cilin subjekti përfiton trajtimin financiar.

6. Kohëzgjatja, mënyra e organizimit dhe procedurat dhe rregullat e angazhimit të subjekteve përfituese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Procedura e kalimit në skemën e trajtimit financiar

1. Institucioni publik i artit dhe kulturës identifikon punonjësit që plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji dhe, kryesisht, fillon procedurën për kalimin e tyre në skemën e trajtimit financiar.

2. Verifikimi i përmbushjes së kushteve kryhet nga institucioni publik i artit dhe kulturës, në bazë të të dhënave dhe dokumentacionit që administrojnë vetë ose që sigurohet nga institucionet kompetente. Në rast nevojë, institucioni kërkon dokumentacion ose informacion shtesë për verifikimin e periudhës së performancës skenike dhe të periudhës së sigurimit shoqëror.

3. Pas përfundimit të verifikimit dhe konstatimit të përmbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 4, institucioni publik i artit dhe kulturës nxjerr aktin për kalimin e subjektit në skemën e trajtimit financiar dhe përcjell aktin dhe dokumentacionin përkatës pranë institucionit përgjegjës për administrimin dhe pagesën e trajtimit financiar.

4. Institucioni përgjegjës për administrimin dhe pagesën e trajtimit financiar, pas marrjes së aktit dhe dokumentacionit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, kryen veprimet e nevojshme për caktimin dhe fillimin e pagesës së trajtimit financiar, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

5. Procedurat, afatet, dokumentacioni që duhet të administrohet dhe mënyra e bashkëpunimit dhe e shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucionit publik të artit dhe kulturës, institucionit përgjegjës për administrimin dhe pagesën e trajtimit financiar dhe institucioneve të tjera kompetente përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Ndërprerja e përfitimit

Përfitimi i trajtimit financiar ndërpritet kur:

a) përfituesi fiton të drejtën për pension pleqërie, invaliditeti ose familjar;

- b) konstatohet se përfitimi është marrë mbi bazën e dokumenteve ose deklarimeve të pavërteta. Në këtë rast, shumat e përfituara padrejtësisht kthehen në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- c) përfituesi kërkon me shkrim ndërprerjen e përfitimit. Ndërprerja e përfitimit nuk sjell humbjen e periudhave të sigurimit të njohura sipas nenit 7 të këtij ligji.

Neni 11

Dispozita kalimtare

Personat që në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 4 të tij identifikohen dhe verifikohen nga institucionet publike të artit dhe kulturës, të cilat kryejnë kalimin e tyre në skemën e trajtimit financiar sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 12

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 3 të nenit 3, pikës 3 të nenit 8, pikës 6 të nenit 8 dhe pikës 5 të nenit 9 të këtij ligji.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi nga data 1 janar 2027.